



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; [kqz.sekretariati@kqz-ks.org](mailto:kqz.sekretariati@kqz-ks.org); [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

**Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**Nr. 43**

Datë: 30. 08. 2017, ora: 9:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP

Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të KQZ nga: 34 – 41/ 2017*

3. Aktivitetet e Sekretariatit

2. Aktivitetet e ZRPP-së

*Shqyrtimi dhe miratimit i rekomandimit për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidateve për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017*

3. Të ndryshme

## **1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të KQZ nga: 34 – 41/ 2017*

**Valdete Daka:** Përshëndetje të gjithëve. Rendin e ditës e keni para jush. A ka dikush vërejtje në këtë rend dite, apo plotësim...? Po urdhëro Ercan...

**Ercan Spat:** E pash tash rendin e ditës, po materialin se kemi...! Si do të hymë në mbledhje, apo unë nuk po mund ta gjej...

**Valdete Daka:** **Ja, materialet janë duke u shpërndarë, ndërkohë** edhe për pikën e tretë, në ndërkohë do ta kemi shkresën nga ministria... Atëherë, kush është për këtë rend dite...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.*

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me pikën e par, miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve 34, 35 dhe deri 41, a ka dikush vërejtje për këto procesverbale. Nëse jo, kush është për miratimin e këtyre procesverbaleve?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalet 34,35,36,37,38,39,40,41/2017 të KQZ-së*

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me pikën e dytë, aktivitetet e sekretariatit. Urdhëro krye shef...!

## **2. Aktivitetet e Sekretariatit**

**Enis Halimi:** Faleminderit kryetare, të nderuar anëtarë, të nderuar të pranishëm. Sekretariati i KQZ-së, ka vazhduar me përmbushjen e obligimeve dhe detyrave që dalin qoftë nga ligji, qoftë nga planet tona operationale. Për sa i takon listës preliminare të votuesve, bazuar në rregullën 02/2013 Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës Votuese dhe me qëllim të krijimit të listës së votuesve, KQZ-ja gjatë procesit zgjedhor pranon ekstraktin e regjistrimit civil nga agjencioni i regjistrimit civil. Me datën 25 gusht, bazuar në planin operacional kemi pranuar ekstraktin e dytë të regjistrimit civil. Pas analizimit të ekstraktit dhe të caktimit të votuesve në qendrat e votimit, lista preliminare të votuesve për zgjedhjet lokale përkatësisht bazuar në ekstraktin e dytë, përmban **1.906.669** emra të votuesve, që i bie 15.435 votues më shumë në krahasim me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017. Numri i votuesve që do të votojnë për herë të parë, është 17.435 dhe, numri i personave që janë larguar si të vdekur pas zgjedhjeve, është 13.991.

Bazuar në rregullën numër 17 dhe në planin operacional, tha z. Halimi, periudha e shërbimit votues për ndërrimin e qendrave votuese, ka filluar me datën 26 korrik dhe përfundon me datën

12 shtator. Deri me 28 gusht, janë aprovuar diku rreth 2.258 kërkesa për ndryshim të qendrave të vendvotimit. Dhe atë: 1.159 kërkesa për ndërrim të qendrave të vendvotimit kanë ardhur përmes aplikimit online. Ndërkaq, përmes Komisioneve Komunale Zgjedhore janë proceduar si të tilla, pra si kërkesa për ndryshim të qendrës së votimit, 1.099 kërkesa për ndryshim të qendrës së votimit. Bazuar në rregullën 2/2013 dhe në planin operacional të zgjedhjeve, Periudhe e kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve ka filluar me 29 gusht, dhe do të përfundoj me datën 12 shtator. Gjatë kësaj periudhe, me qëllim realizimin efikas të kësaj periudhe janë shtypur listat preliminare të votuesve për çdo komunë, është bërë shpërndarja e tyre dhe qytetarët kanë të drejt të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për ta konfirmuar, përkatësisht për ta sfiduar listën votuese. Numri i personave që u është marr aftësia e veprimit me vendim gjyqësor të prerë, është 150 persona. Ndërkaq, sa i përket votimit jashtë Kosovës, periudha ka filluar me 16 korrik, dhe ka përfunduar me datën 23 gusht.

Divizioni i shërbimit votues, para fillimit të periudhës për votim, ka dërguar 15.118 për regjistrim të votuesve që në zgjedhjet e parakohshme parlamentare kishin arritur të dëshmonin kriteret e zotësisë juridike për të votuar. Informatat e nevojshme janë publikuar po ashtu, edhe në ueb-faqe për zgjedhjet lokale që do ta mbahen me 22 tetor. Gjatë kësaj periudhe, aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, pra 16 gusht 2017, iu kanë përgjigjur 11.813 aplikacione për regjistrim. Nga ky numër, 11.813 aplikacione, 4.728 zarfe me aplikacione janë pranuar nga posta në famën postare të KQZ-së, 63 aplikacione janë pranuar përmes faksit, 7.022 janë pranuar përmes e-mailit që e kemi zyrtar për këtë çështje. Si më poshtë, keni edhe rezultatet nga vlerësimi i aplikacioneve të cilat nuk do të, pra i keni informatat e shpërndara, pra numrin e aplikacioneve të pranuar sipas shteteve dhe të aprovuara dhe të refuzuara të shpërndara në formë tabelore në faqen katër. Po ashtu, e keni edhe numrin e aplikacioneve të aprovuara të shpërndara sipas interesit të votuesve potencial, pra sipas komunave në nivel të Republikës së Kosovës. Po ashtu në kuadër të sekretariatit përgjatë kësaj periudhe të votimit të fundit, janë zhvilluar aktivitete komfor planit operacional, pra po vijon mbushja e obligimeve dhe detyrave tona, faleminderit.

**Valdete Daka:** A ka dikush pyetje?

**Betim Gjoshi:** Kryetare nëse më lejon, tek të dhënat që i keni për Listën Votuese, konsideroj që ka rrjedhë një gabim. E para, keni thanë që 15.435 votues janë më shumë, qa keni konsideruar edhe numrin e votuesve të ri që janë për herë të parë, ndërsa po thuhet që janë larguar 3.99...Duhet me qenë, 11.000-12.000 votues më shumë. Keni diçka gabime matematikore...

**Enis Halimi:** Po, ndoshta mund të ndodh prej shërbimit përkatës, do ta korrigjojmë këtë dhe të korrigjuar besoj do ta sjellim. Mund të jetë ndonjë lëshim teknik, faleminderit...

**Valdete Daka:** A ka dikush ndonjë pyetje tjetër?

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit kryetare, faleminderit krye shef për informacionet. Në fakt, është dashur të na dërgojnë pak më herët këtë raportin për votimin jashtë vendit, pak më herët, se na e dimë që ka përfunduar procesi para disa ditëve dhe, nuk është se kemi pasur ndonjë informacion për numrin e aplikacioneve të pranuar në mënyrën si kanë ardhur dhe për numrin e atyre që janë aprovuar...Sido që të jetë, unë kam një pyetje në lidhje me informimin publik: po

më intereson deri ku ka mbërritur procesi i votuesve për gjitha periudhat, a kanë filluar aktivitetet e informimit dhe edukimit votuesve edhe për periudhat që kanë, që janë në proces dhe që janë në pritje nga ajo që u tha....? Procesi i ndërrimit të qendrës së votimit vazhdon edhe për disa ditë, sikurse ka filluar periudha e sfidimit të listës së votuesve...

**Enis Halimi:** Besoj e dimë gjithë sagën që kemi me procedurat për zgjedhje, pra edhe për operatorin për informim publik për këto zgjedhje, komfor rekomandimeve që kanë dalë, qoftë nga këshilli informimit publik, qoftë nga takimet e punës për të shtri informacionin tek publiku përkatësisht popullata...Ne, kemi marrë gjitha aktivitetet e tjera që bëhen në mungesë të informimit publik klasik të cilin e bëjmë, ndërkaq, është punuar me zyrtarët komunal përmes të cilëve, ne jemi përpjekur që në koordinim me IFES-in të ndajmë informacione që kanë të bëjnë me fazat e procesit zgjedhor. Besoj që, është një lajm i mirë që do të nënshkruajmë edhe kontratën dhe pastaj, do ta kemi më të lehtë...

### **3. Shtimi i numrit të asamblistëve të Komunës së Vushtrrisë**

**Valdete Daka:** Faleminderit krye shef, a ka dikush ndonjë pyetje? Nëse jo vazhdojmë me pikën tjetër, e ajo është rritja e numrit të anëtareve të Kuvendit të komunës së Vushtrrisë. Siç e dini në mbledhjen e fundit, KQZ-ja ka marr vendim të dërgoj një shkresë Ministrisë së Administrimit Lokal ku, ka kërkuar që Komuna e Vushtrrisë të mbetet me numrin e njëjtë të anëtareve të kuvendit që ka qenë në zgjedhjet e vitit 2013, duke marrë parasysh numrin e popullsisë dhe procesin e regjistrimit të popullsisë. Ndërkohë, këto momente kemi marr shkresën nga kjo Ministri në të cilën, është marr qëndrim që konfirmohet se komuna e Vushtrrisë, do të mbetet me numrin e njëjtë të anëtareve të kuvendit, siç ka qenë në zgjedhjet e vitit 2013. Numri i asamblistëve, është 35. Pra, e keni shkresën e nënshkruar nga Zëvendësministri apo dikush tjetër, nuk e shikove por, kryesorja është se shkresë është zyrtare...

**Betim Gjoshi:** Është mirë që komunës së Vushtrrisë, realisht subjekteve politike në Vushtri po ju kthehet një e drejtë që vetëm e kanë pasur. Na, edhe në mbledhjen e fundit, kërkesën kur e kemi dërguar, kemi parë që të gjitha të dhënat tregojnë se komuna e Vushtrrisë duhet të ketë 35 asamblistë, dhe jo 34, siç edhe ishte në shkresën paraprake... Unë, e falënderoj Ministrinë e Pushtetit Lokal që ka marr parasysh kërkesën tonë dhe ka rritur numrin, por neve na duhet sot që subjekteve politike që garojnë në këtë komunë, t'ua mundësojmë një afat me i sjellë katër kandidaturat të cilat, ne ua kemi mohuar duke u bazuar me një shkresë të mëhershme të Ministrisë së Pushtetit Lokal. Mendoj të jetë e shtune ose e diele afati i fundit për t'i sjellë, që të hënën ti certifikojmë kur jemi në rregull me afatet ligjore, faleminderit.

**Adnan Rrustemi:** Është mirë që po përmirësohet një konstatim i pa drejt, besa dhe i paligjshëm për zvogëlimin e numrit të anëtareve të Kuvendit Komunal në Vushtri. Siç e dimë, ligji për vetëqeverisjen lokale, përcakton qartë sendet bazë të kriterit dhe numrit të banorëve që përcaktohet deri në cilin numër të banorëve i përket ky numër. Vushtrria, hyn në komunat që kanë mbi 70.000 banorë, dhe rrjedhimisht, i takojnë 35 anëtarë. Kështu, i ka pasur edhe në 2013, unë mendoj që kjo shkresë e plotëson këtë aspekt, pajtohem që ti jepet një mundësi shtesë një afat subjekteve politike që të bëjnë plotësimet. Personalisht, mendoj që të dielën, të hënën ta

përfundojmë procesin dhe të jemi në përputhje me planin operacional kur bëhet fjalë për afatin e hedhjes së shortit që duhet të përmbillet certifikimi dhe tutje le të vazhdon njëjtë me procedurat e tjera.

**Valdete Daka:** Faleminderit Adnan, këto momente i njoftoj Bajramin e Nenadin se tash, e merrni edhe kopjen në gjuhen serbe dhe boshnjake, të njëjtës shkresë prej ministrie, vetëm sa ta printojnë. Faleminderit për mirëkuptim, atëherë nëse nuk kemi edhe diçka tjetër me këtë pikë na mbetet vetëm që...

**Betim Gjoshi:** Atëherë, le të mbetet të dielën deri në ora 4:00...

**Binak Vishi:** Është shumë deri të dielën me ju dhënë afat sepse, partitë kanë me i shtue vetëm katër kandidat...mendoj që deri të shtunën...sepse, janë katër persona, herë shtatë subjekte politike, janë 21 njerëz m'u verifikuar janë shumë deri të dielën, është kohë e gjatë.

**Valdete Daka:** Atëherë kush është për...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan propozim që deri të dielën t'i jepet afat subjekteve politike që garojnë në komunën e Vushtrrisë, t'i sjellin emrat e katër kandidatëve shtesë.*

## **2. Aktivitetet e ZRPP-së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve për Zgjedhjet Lokale të 22 tetorit, 2017*

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me pikën tjetër ajo është aktivitetet e ZRPP-së, shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikimin e subjekteve dhe kandidatëve për zgjedhjet lokale të 22 tetorit. Urdhëro drejtoreshë...

**Miradie Mavriqi:** Faleminderit e nderuara kryetare, të nderuar anëtarë të KQZ-së. Deri me sot, zyra për regjistrimin e partive politike dhe certifikim është në proces të kontrollimit të kandidatëve të subjekteve politike, mirëpo janë procese do të thotë janë kontrolluar dokumentacioni i 91 subjekteve politike të cilat kanë aplikuar për certifikim, dhe atë janë 35 parti politike 1 koalicion, 30 nisma qytetare dhe 25 kandidat të pavarur. Zyra, në përputhje me nenin 15 dhe 25 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe nenit 14 të ligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, nenit 4 të rregullës zgjedhore numër 8/2013, certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Sipas atyre kushteve, janë parashtruar për aplikacion për certifikim, janë të përmbushura sepse subjekti politik ka paguar fillimisht ka paguar gjobot e shqiptuara nga KQZ-ja dhe nga paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pastaj subjekti politik ka parashtruar gjithashtu formularin e përcaktuar nga KQZ-ja për kërkesë certifikimi duke përfshi theksimin në të cilin aplikon për kryetar komune apo për kuvendin komunal. Subjekti politik ka dërguar kopjen e shenjës së partisë dhe gjitha dokumentacionet që i kërkojmë, gjithashtu ka dërguar një deklaratë politike që i përmban deri në 150 fjalë si dhe nënshkrimi dhe

pagesa për certifikim për ato komuna për ato vende që nuk ka pasur nga zgjedhjet e kaluara. Prandaj zyra rekomandon me që procesi i certifikimit të kandidatëve do të zgjatet deri në aplikimin e këtyre kandidatëve të tjerë dhe në mënyrë që të pronësohen të gjithë kandidatët, se janë mbi 70.000 kandidatë rekomandojmë që për mbledhjen e radhës të certifikohen kandidatët kurse sot rekomandohen të certifikohen 91 subjekte politike, faleminderit.

**Betim Gjoshi:** E para, unë e falënderoj zyrën për punën që ka punuar këto ditë deri në mesnatë, ndoshta edhe më shumë por unë kisha kërkuar që më mirë ka qenë të bëhet një pauzë, qofte se duhet të certifikohen edhe kandidat. Por, besoj se ka qenë më mirë me përfunduar procesin komplet të certifikimit të kandidatëve dhe subjekteve politike për arsye se janë ndërlidhur njëra me tjetrën, mendim i jemi është nëse më përkrahin kolegët ndoshta ka qenë mënyra më e mirë.

**Adnan Rrustemi:** Edhe unë pajtohem që më së voni në 10:30. Këtu keni përgjegjësi të dyfishtë, ne certifikojmë edhe subjekte, edhe kandidat, madje më shumë kandidat se subjekte... Unë mendoj se duhet t'i kemi listat, CD-të për asamble, po edhe një informatë se cili kandidohet për kryetar, cili për asamble të paktën, ato shifra na i keni dërguar që natën e aplikimit por, edhe emrat duhet t'i kemi të bashkangjitur, ndërsa afati i së hënës nuk mendoj që duhet m'u përdor..., tash e kemi edhe rastin e Vushtrrisë për gjitha listat.

**Miradie Mavriqi:** Një raport apo një rekomandim i këtyllë, kishte me marrë deri në 200 faqe, nëse më lejoni atëherë, ua përgatisim vetëm në CD-të, dhe do t'i keni kandidatët e subjekteve politike.

**Betim Gjoshi:** Unë i kam disa pyetje kryetare... Unë, edhe njëherë e falënderoj zyrën që na ka dhënë me shkrim, që janë kryer disa çështje që ndërlidhen me certifikimin e subjekteve politike. Ne si Komision Qendror Zgjedhor, e kemi për detyrë që t'i verifikojmë të gjitha përshtatshmërinë e partive politike që kanë kandiduar, dhe kandidatët individualisht... Unë si anëtar i KQZ-së, më kishte interesuar që të na jepet një garanci prej zyrës se, a janë verifikuar personat të cilët janë në listë, a kanë përshtatshmëri me nenin 29, mos janë të dënuar me vepër të formës së prerë në tri vitet e fundit, pa marr parasysh llojin e veprës penale ashtu siç e parasheh ligji, se mos ka ndonjë vendim të PZAP-s që ju ndalon me marr pjesë në zgjedhje... Sot, të paktën e pash një të tillë në listën të kandidatëve, nuk e di a është larguar...! Pastaj, se a kanë arritur t'i paguajnë gjobat individualisht personat të cilët i certifikojmë individualisht, sipas 19 pikave që i parasheh neni përkatës, se për neve është e jashtëzakonshme...!

Në të njëjtën kohë, thaq z. Gjoshi, kisha shfrytëzuar opinionin për informim se pas certifikimit (këtë do ta kërkoj edhe në momentin kur ti certifikojmë), kanë të drejt ankese edhe në PZAP për secilin kandidat që e certifikojmë, dhe e kisha lutur zyrën për regjistrim të partive politike që në momentin e certifikimit t'i publikoj kandidatët në ueb-faqe, së paku ata kandidatët që i kemi certifikuar që t'i japin mundësi opinionit me i sfidue ata pranë PZAP-s, nëse për ndonjërin nga ata dikush mendon se, nuk ka përshtatshmëri bazuar me ligjin.

Ne, tha z. Gjoshi, duhet me mbërrit një standard që ligjet m'u respektuar në pikë dhe presje, ne nuk mund të krijojmë standarde të dyfishta, p.sh., krahasuar me kandidatët e përgjithshme dhe

zgjedhjet lokale për arsye se, kushtet e njëjta janë dhe ne duhet të kemi tashmë një garë korrekte dhe se kjo, është edhe kërkesë e gjithë shoqërisë në Kosovë...

**Valdete Daka:** Sa i përket kërkesës, se a janë personat të cilët kandidojnë si të dënuar në 3 vitet e fundit, unë personalisht e kam dërguar shkresën në Këshillin Gjyqësorë të Kosovës me një kërkesë sepse, për ne ka qenë e pamundur që individualisht secilin me e kontrolluar. Këshilli Gjyqësor, ka marrë përsipër që ta bëjë verifikimin në 7 Gjykatat Themelore të Kosovës dhe, t'i verifikoj listat se a ka në mesin e këtyre kandidatëve, kandidat të cilët në 3 vitet e fundit janë të dënuar me vendim të plotfuqishëm në ndonjë gjykatë të Kosovës. Mirëpo, deri në këto momente ne nuk kemi marr informacione me shkrim nga ata, apo çfarëdo informate. Megjithatë, kam biseduar dhe më kanë njoftuar se gjatë ditës sotme, do ta dërgojnë këtë shkresë po edhe në qoftë se nuk e dërgojnë, KQZ-ja rezervon të drejtën që në momentin që vjen shkresa dhe ta kemi informatë se ndokush prej kandidatëve është i dënuar ashtu siç parasheh ligji, atëherë të bëhet de certifikimi i tij nga ana e KQZ-së. Sa i përket PZAP-s, drejtoresha mundet me na informue...

**Miradie Mavriqi:** Ne prej PZAP-s, kemi kërkuar me shkresë për njoftimin e KQZ-së që ka ndonjë subjekt politik gjoba të papaguara, që do të thotë se PZAP e ka dorëzuar atë vendim..., gjithashtu, e ka dorëzuar shkresën dhe vendimin lidhur me kandidatët të cilët kanë qenë të dënuar për mos pjesëmarrje në zgjedhje...Ne, i kemi kontrolluar kandidat për kandidat, do të thotë zyra e ka plotësuar kërkesën e PZAP-s dhe, një kandidat i cili ka qenë i dënuar nga PZAP nuk ka hyrë në listë dhe, lidhur me këtë është njoftuar edhe subjekti politik...

**Betim Gjoshi:** Në bazë të ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në momentin që dikush edhe sot e tutje e humb, jo vetëm nëse na kthen gjykata, këshilli gjyqësorë por, nëse ai tani e humbë të drejtën për të qenë kandidatë bazuar nga këto kushte, kemi të drejtë për ta larguar nga lista. Është një afat që ju lejohet se, brenda cilës periudhë subjekti politik mundet me zëvendësuar kandidatin në rastet kur kjo lejohet....! Përveç kësaj, ekziston momenti për ankesë në PZAP...Edhe njëherë, unë ju drejtohen qytetarëve, shoqërisë civile dhe të gjithë atyre që kanë ndonjë argument për dikë që është në listë dhe që nuk duhet me qenë në listë, në përputhje me nenin 29, bazë nenit 122 të ligjit ta shtrojë ankesën në PZAP brenda 24 orëve, siç e parasheh ligji prej momentit që ne e publikojmë listën...

**Nenad Rikallo:** Unë, pajtohem me propozimin e kolegëve që ne të kemi një pauzë deri sa të përgatiten materialet dhe të na sillen...Dhe të na sillen CD-të, dhe ne ti kemi...në këtë interval pauze sepse, është mirë që ta kemi një pasqyrë përpara...Sepse, ne nuk duhet të bëjmë ndonjë gabim, dhe se ne kur të kthehemi në vazhdim të mbledhje të dimë qartë se çka po votojmë...

**Valdete Daka:** Faleminderit, unë kisha propozuar që në orën 11:00 ta kemi materialin e gatshëm CD-të, që deri në orën 11:00 t'ju jepet mundësia anëtareve që t'i hapin ato CD, dhe ti shikojnë...

**Betim Gjoshi:** Kryetare, kur kanë mundësi ma shpejt le të na bien edhe le të na dërgojnë në e-mail se, kanë mundësi t'i dërgojnë me e-mail që na ti krahasojmë.

**Valdete Daka:** Nëse është fondi i madh, atëherë i dërgoni në e-mail. Atëherë, në orën 11:00 vazhdimi i mbledhjes.

**( Ora: 11:00. Vazhdim i mbledhjes )**

**Valdete Daka:** Faleminderit të gjithëve që keni pas durim...Drejtoreshë, në qoftë se keni diçka për të shtuar urdhëro, tani i kemi listat me numër të kandidatëve.

**Miradije Mavriqi:** Kryetare, tash është i kompletuar rekomandimi d.m.th., komunë për komunë secili subjekt politik për ku ka aplikuar edhe do të thotë nuk kam nevojë unë për ta shpjeguar, është numri total i kandidatëve për komunë e subjekt politikë...

**Valdete Daka:** Faleminderit drejtoreshë, atëherë unë po filloj me lexim. Atëherë, lista e subjekteve politike për zgjedhjet Lokale është si në vijim:

*LDK me 899 kandidatë për kuvend komunal dhe me 28 për kryetar komune, PDK me 967 kandidatë për kuvende, 30 për kryetar komune, AAK me 853 kandidatë për kuvende , 25 për kryetare komune, VV me 874 për kuvend, 26 për kryetarë komune, AKR me 528 kandidatë për kuvend, 16 për kryetar komune, NISMA me 695 kandidatë për kuvend komunal, 22 për kryetarë komune, FJALA me 109 kandidatë për kuvende, 6 për kryetarë, ALTERNATIVA me 168 për kuvende, 5 për kryetarë, PD me 167 për kuvende, 1 për kryetarë komune, SRPSKA LISTA me 272 për kuvende komunale, 10 për kryetarë komune, PARTIA URA me 22 për kuvende, nuk ka kandidatë për kryetarë, BALLI KOMBËTARË me 7 kandidatë për kuvende komunale pa kandidatë për kryetarë , ORGANIZATA E BALLIT KOMBËTARË me 57 kandidate për kuvende komunale, PARTIA EKOLOGJIKE E KOSOVËS me 9 kandidatë për kuvende komunale, PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE me 51 kandidatë për kuvende, LËVIZJA QYTETARE VATRA 37, PARTIA DEMOKRATIKE E ASHAKLINJËVE TË KOSOVËS 63, STRANKA DEMOKRACI AKCIJE 8, STARMOSTANLA LIBERALNA STRANKA 68, INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS 10, GRACANSKA INICJATIVA GORE 6, POKRCKA GORE 6, PARTIJA KOSOVSKI SERBA 21 kandidat për kuvende 1 për kryetarë komune. Partia e ASHKALINJEVE PËR INTEGRIM 40 kandidat për kuvende 1 për kryetarë komune. KOSOVA TYRK ADALET PARTI 28 për kuvendë, 1 për kryetarë komune, PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA 29 për kuvende komunale 1 për kryetarë komune. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA 39 për kuvende 1 për kryetarë, NAPREDNA SNAGA KOSOVA 5 për kuvende, 1 për kryetarë. JEDINSTINA GORANSA PARTIJA 16 për kuvende, 1 për kryetarë. AKTIVNA GRACANSKA INICJATIVA 9 për kuvende. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA 3 për kuvende. LEVIZJA PËR BASHKIM 133 për kuvende, PARTIA SOCIAL DEMOKRATE 25 për kuvende, PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS 60 për kuvende, KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI 84 për kuvende , 2 për kryetar komune. Ndërkaq në vijim i kemi koalicionet: koalicioni VAKAT 58 kandidatë për kuvende, 1 për kryetar komune. INICIATIVA E THERANDËS nisem qytetare 34 kandidatë për kuvende komunale pa kandidatë për kryetar komune, LISTA PËR KAQANIKUN 17 për kuvende, GRACANSKA INICJATIVA MLADI 4 kandidat për kuvende, INICIATIVA*



*SHQIPTARE PËR SYRINIK 17 për kuvende 1 për kryetar , INICIA E TË PAVARURIT E ISTOGUT 15 për kuvende 1 për kryetar, INICIATIVA QYTETARE LËVIZJA PËR DREJTËSI DHE UNITET 13 për kuvende, INICIATIVA PËR NOVOBËRDËN 7 për kuvende , INICIATIVA QYTETARE PËR DRENASIN 14 për kuvende 1 për kryetar komune, IQ 41000 , 13 për kuvende, GI DEMOGRANSKA INICIATIVA 17 për kuvende, NARODNA PRAVDA 5 për kuvende 1 për kryetar, NARODNA JODINCA 9 për kuvende, INICIATIVA SHQIPTARE PËR KLLOKOT 14 për kuvende 1 për kryetar,GI KLLOKOT / VËRBOCI6 për kuvende, INICIATIVA QYTETARE KLLOKOT MOGILL 6 për kuvende, INICIATIVA E PAVARUR E ISTOGUT 15 për kuvende 1 për kryetar, INICIATIVA QYTETARE SHQIPTARE 11 për kuvende, GI CENTRAL KOSOVO 13 për kuvende, GI ZA EVROPSKO POMORAVLE 9 për kuvende, INICIATIVA QYTETARE PËR PROGRESIN E KLINËS 21 për kuvende, GI NARODNA SLLOGA 17 për kuvende 1 për kryetar, GI LIPJAN NASHA KUQA 5 për kuvende, NISMA QYTETARE PËR FERIZAJIN 18 për kuvende 1 për kryetar, GIS OLIVER IVANOVIQ 48 për kuvende 2 për kryetar, , GRACANSKA INICJATIVA ZA ZUBIN POTOK 8 për kuvende 1 për kryetar, GRACANSKA INICJATIVA ZAJEDNO 5 për kuvende, VIZIONI PËR DRENAS 34 për kuvende 1 për kryetar komune, GI NOVI POQETAK 10 për kuvende 1 për kryetar komune , BEKIM JASHARI kandidatë i pavarur, REFKI SUMA kandidat i pavarur për kryetar , Besim Misini kandidat i pavarur për asamble komunale , Betim Ibishi për asamble , Nexhmedin Haxhiu për asamble, Basri Ibrahimimi për kryetar, Basri Gashani për asamble, Hamit Kastrati për asamblist, Selajdin Bytyqi për kryetar, Fatmir Rashiti për kryetar, Radin Kokbelloshevic për asamble, Sllavisha Malikovic për asamble, Sali Meha për asamble, Mehi Sali për asamble, për kryetarë Adem Beqiri, Nexhat Krasniqi për kryetarë, Smajl Mustafa për asamble, Arben Nika për asamble, Isref Elshani për asamble, Naim Zeqiri për asamble, Bojan Sajqic për asamble, Shaip Shala për kryetar komune, Fisnik Gjinaj për kryetar, Ylber Islami për kryetar, Riza Kryeziu për kryetar , pra këto ish parti të politike gjithsej 35 parti politike 1 koalicion 30 nisma qytetare dhe 25 kandidatë të pavarur me gjithsej 7080 kandidatë për kuvende komunale dhe kandidatë për kryetar të komunave , këto janë pra të gjitha ata që kanë aplikuar dhe kanë kaluar verifikimet e nevojshme dhe sipas rekomandimit të zyrës, rekomandohen për certifikim për këto zgjedhje lokale ,a kemi ndonjë pyetje për drejtoreshën!*

**Sami Hamiti:** Nën numrin 43 jeni, Iniciativa e Pavarur e Istogut, e keni të përsëritur në 54. Iniciativa e Pavarur e Istogut. A është e dublifikuar apo është gabim...? Është e njëjta e përsëritur: 92 janë në listë, prandaj po them...!

**Adnan Rrustemi:** Edhe në dokumentin që na u është dërguar, por edhe në këtë që është printuar. Koha ishte shumë e shkurtër. Secili prej nesh, por edhe zyra duhet me verifikuar.

**Valdete Daka:** 43 dhe 51 janë të njëjta.

**Eshref Vishi:** Do të ishte mirë zyra t'i verifikoj me saktësi të gjitha aplikimet mos eventualisht kemi s'përputhje te numrat. Ka qenë një kohë shumë e shkurtër, prej orës 10-13 me i përmbledhë të gjitha.

**Betim Gjoshi:** Faleminderit, kryetare! Mendoj që përveç këtyre përmirësimeve, është shumë e rëndësishme me i publikuar këto lista, që më ia ofruar transparencën e nevojshme që personat që kanë interes juridik, qytetarët e Kosovës, shoqëria civile, mediet, partitë politike e kushdo tjetër me i apeluar, por edhe me u njohur me kandidat që janë. Ne na u ka përcjellë një data bazë me të dhënat e këtyre kandidatëve. E kemi para vetës. Është mirë që dallohen kandidatët për kryetarë komune dhe asamble. Në këtë data bazë. Besoj që pas kësaj mbledhje zyra mundet me përgatitë. Dhe nëse ka ndonjë përmirësim të tillë, siç po e theksojmë në rastin konkret të këtyre dy subjekteve me të njëjtin emër. Ne i kemi pasur edhe në një listë më herët, ndoshta edhe me këtë është mirë me krahasuar. 43 ishte e njëjtë me 54. Edhe herën e kaluar e paskemi pasur të njëjtën. Ndoshta i kemi edhe 90 subjekte, në bazë të kësaj, sepse ka mundur një subjekt me u ngatërruar dhe me u shënuar në dy vende. Kuptohet si rezultat i punës së madhe, sepse po flasim për mbi 7000 kandidat. Është mirë të ofrohet transparenca e nevojshme dhe palëve t`u jepet mundësia që të ankimojnë.

Unë, tha z. Gjoshi, pres ta caktojmë si afat të ankesave orën 1, në këtë kohë të publikohen dhe nga ajo kohë të rrjedhë afati për ankesa, sepse ligji thotë prej momentit kur palët munden me u njoftuar. Unë e përgëzoj zyrën për punën e madhe që ka bërë. Mos të harrojmë që ne nuk e kemi kryer të gjithë punën rreth përshtatshmërisë së kandidatëve. Neve ende, KGJK nuk na ka kthyer përgjigje se a janë dënuar këta persona a jo. Si rezultat i kësaj të vetmen mundësi e kemi që me i publikuar. në rast që na sjellë KGJK, ndërkohë me i de certifikuar, nëse jo qytetarëve Brenda 24 orëve me i`u drejtuar për ankesa PZAP-it. Faleminderit!

**Adnan Rrustemi:** Veç një sugjerim në aspektin teknik në ueb faqe mos të publikohet lista tërësisht po le të ndahet për secilin subjekt politik lista e saj e kryetarëve dhe asamblistëve për secilën komunë për verifikime shumë faleminderit.

**Valdete Daka:** Përveç këtyre përmirësimeve...

**Bajram Ljatifi:** Duhet të kemi kujdes se, kur duhet të jetë koha e ankesave, për këtë duhet të kemi kujdes...Materiali është mirë, por shikoni se ka gabime teknike në shkronja...në shkrim...Janë disa raste...

**Valdete Daka:** Nuk e di a do të mundemi të dielën sepse Vushtrrisë i kemi lënë afat ... Të hënë mundemi me i përfunduar.

**Betim Gjoshi:** Jo zyrtarisht, jam i njoftuar edhe unë sa i përket alfabetit dhe shkronjave gjatë bartjes prej regjistrimit civil dej te na kanë ndodh disa probleme për shkak të formateve të ndryshme të programeve të kompjuterit po e zëmë kemi pasur me Q-ja kanë dalë C-ja e ngjashme kështu që ndoshta është mirë mu shikuar edhe një herë për këtë d.m.th duhet mi publiku, edhe kandidatët vet munden me pas mundësin për të kërkuar përmirësimin në bazë të asaj që kanë në letërnjoftim.

**Adnan Rrustemi:** Pikërisht, ju duhet me reflektuar komplet të dhënat që kanë në regjistrin civil.

**Valdete Daka:** Mirë, atëherë a mjafton koha deri në orën 1 drejtoresh a po deri në orën 2 ta lëmë më mirë për me i publikuar në Ueb faqe, ose deri në ora 3...Ose, po e lëmë deri në ora 4...Mirë, atëherë kush është që ti certifikojmë këto subjekte politike që kanë konkurruar me kandidatët e tyre...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për certifikim të Subjekteve Politike dhe  
Kandidateve për zgjedhjet lokale të 22 tetorit, 2017*

**Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----